



01 Nr. 223/25 Dt. 03.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja b) dhe d) të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008"), neni 12 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin, dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 15 të Rregullores 001-011-141691 datë 28.09.2023 për Organizimin, Funksionimin, dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Prizrenit, dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për kompensim të kryetarëve të Këshillave të Lokal të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjet Urbane

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për kompensim për kryetarët e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane në tërë territorin e Komunës së Prizrenit.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e kryetarëve të Këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane të Komunës së Prizrenit.
6. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

